



Revista Albanët

1-3 ➤ INTERVISTË ME ZONJËN E
ALBANËVE

5 ➤ NJË EKSPERIENCË
PËRGJEGJËSIE E MATURIMI.

4 ➤ KARTA E PERFORMANCESH

6-7 ➤ TETORI I LIBRIT

8-9 ➤ ALBANËT HIGH-TECH

10-11 ➤ REPORTAZH

12-13 ➤ MANDALA

14 ➤ ALBANËT ZBATIMI I PROGRAMIT
TË KODIMIT

15 ➤ PROFIL BOKSIERI
ESIOR NOKA

16-17 ➤ SHKODËR - NJË DITË NDRYSHË..

18-19 ➤ KARTOLINA TË NXËNËSVE
ALBANË PËR BABAGJYSHIN

CREATED WITH



ALBANËT
SHKOLLA 9-VJEÇARE

**REVISTA ALBANËT
U RIKTHYE!**

INTERVISTË ME ZONJËN E ALBANËVE

Redaksia jonë në këtë numër të rikthimit të Revistës Albanët, ka intervistuar drejtoreshën ekzekutive të shkollës znj. Irena Mane. Drejtoresi  Irena, ka zbuluar për nxënësit edhe disa "të fshehta", që duhet t'i lexoni në këtë intervistë me sfond Lulen e Krishtlindjes.

Përshëndetje drejtoreshë Irena! Ne jemi një grup nxënësish, që i shprehëm redaksisë dëshirën për t'ju intervistuar, mund ta bëjmë joformale këtë intervistë?

Irena Mane – Përshëndetje. Po patjetër, si të dëshironi.



1. Ju pëlqejnë intervistat apo ju pëlqen të punoni në prapskenë?

Irena – Më shumë më pëlqen të punoj në prapskenë (qesh), por respektoj çdo dëshirë dhe interes mësimor dhe jo vetëm mësimor të nxënësve, që zhvillojnë intervistën. Shpesh kjo është mënyra më efikase për të njobur njëri – tjetrin dhe mënyrën se si dhe çfarë mendojmë. 

2. I sati vit është ky në drejtimin e “Albanëve” dhe si do ta përkufizonit këtë periudhë?

Irena – Ky është viti i tetëmbëdhjetë në drejtimin e shkollës. Por përpara se të hapej shkolla, kam drejtuar kopshtin “Iliria” për 7 vite. Në total kam 25 vite, që drejtoj një institucion arsimor, kopësht dhe shkollë jopublike në Tiranë. Është një periudhë relativisht e gjatë, që i ka pasur brenda të gjitha: èndrrat, sfidat, lodhjen, kënaqësinë për punën, dështimet e vogla dhe sukseset e mëdha.

3. Cila pjesë e punës suaj në drejtim është më e vështira?

Irena – Pjesa më e vështirë është përgjedhja, trajnimi, kontrolli dhe motivimi i stafit në përgjithësi e veçanërisht mësuesve tuaj. Nuk është e lehtë që të gjesh dhe “rritësh” nga ana profesionale mësues të moshave dhe formimeve të ndryshme. Akoma më e vështirë është që mësuesit t’i përshtaten me mësimdhënie brezit dhe kohës tuaj të teknologjisë. Dhe akoma më e vështirë, që mësuesi të përdorë metoda mësimore, teknika, mjete e burime, ku nxënësi me kënaqësi të përfshihet dhe ta nxjerrë vetë hap pas hapi, duke e provuar mësimin. Kjo është një sfidë, që ne përpinqemi ta fitojmë çdo ditë, çdo muaj, çdo vit. Kemi patur shumë ndryshime pozitive, por kemi edhe shumë për të bërë.

4. Po më emocionuesja, pjesë e punës?

Irena – Puna jonë është e lodhshme dhe ndonjëherë konsumuese. Arsyja pse unë vazhdoj të punoj me të njëtin pasion edhe pas kaq vitesh, është emocioni pozitiv e shpesh i papërsëritshëm që marr, emocione të forta e ndonjëherë të paharrueshme, që ky profesion të jep.

Do të më lejoni të përmend 4 momentet më emocionuese që merr çdo mësues, dhe akoma më shumë personalisht, si drejtuese institucioni.

- Rezultatet e larta të nxënësve në provimet kombëtare e ndërkontebtare.
- Rezultatet e larta të ish nxënësve Albanë në shkollat e mesme, pavarësisht nëse te ne kanë shkëlqyer apo jo.
- Sukseset e ish nxënësve tanë në kolegjet dhe universitetet më prestigjioze në botë apo në kompanitë më të mëdha ndërkontebtare.
- Por ndonjëherë emocioni që marr nga nxënësit, që në një moment të caktuar bëjnë ndryshim në qasjen që kanë për shkollën dhe janë duke realizuar objektivat e tyre, të vëna së fundmi, është shumë i bukur. Po aq bukur është që të ndjesh çdo ditë se i gjithë institucioni që ke ngritur vetë, pra të gjithë stafin, e lidh një fill i bukur harmonie, pozitiviteti dhe miqësie.



5. Gjatë këtyre viteve dhe gjithë këtij rrugëtimi ju kanë mbetur në mendje emra dhe ftyra nxënësish, pra a veçoni për mirë ose jo nxënës, që ju vazhdoni të mbani kontaktet, i keni përzemërt dhe ndiqni ecurinë e tyre?

Irena – Është një listë e gjatë emrash dhe historish suksesi, që shtohet çdo vit. Me shumë prej tyre, brenda apo jashtë vendit, mbaj kontakte të vazhdueshme. Çdo sukses apo mesazh i tyre më zbuluron ditën dhe jetën. Jam krenare për Albanët, kudo ku janë. Kur ju kemi këtu jemi të përfshirë shumë në ecurinë tuaj mësimore dhe edukimin tuaj, dhe nuk i kuptojmë përmasat e punës sonë. Por kur largoheni nga këtu, çdo arritje, na vjen si dhuratë.

6. Cilin nga aktivitetet e zhvilluara nga nxënësit albanë do të veçonit si më argëtuesin për ju, që e keni ndjekur dhe do vazhdoni ta ndiqni gjithmonë me dëshirë?

Irena – Janë shumë, por do të veçoja koncertet e bëra në fundvitet para pandemisë, me numrat më të spikatura në aktrrim, muzikë e kërcim, koncertin për nënët, përbëlljet e javëve të projekteve dhe "Albanët got talent" ej rastin të falenderoj të gjithë stafin mësimdhënës, por në mënyrë të veçantë mësuese Kozin, Suelën, Lirën dhe profesor Gjergjin, që aktualisht jeton në Itali. Është fat të punosh me njerëz të tillë, që kanë një nivel të lartë profesional.



7. Në gjithë këto vite punë, përvojë e kujtime cila ka qenë gjëja më e vështirë për tu arritur dhe cila është ajo që punoni ende për ta realizuar, pra cila është ambicia juaj aktuale?

Irena – Unë jam e vetëdijshme që kemi arritur shumë. Punën dhe arritjet tona i vlerësojnë kolegët në shkollat e mesme, prindërit dhe familjet e nxënësve. Rankimi të dytët për të dytin vit radhazi, është një evidentim nga ZVA i punës dhe rezultateve tona. Qëllimi final për të cilin po punoj aktualisht është krijimi i një model suksesi real dhe të shkruar, i një modeli të një shkolle shqiptare, që forcon identitetin dhe traditën më të mirë kombëtare, por zgjedh të përshtatë edhe përvojën më të mirë të vendeve të zhvilluara. Dhe të gjitha këto me moton 'Në shkollën tonë nuk përgatisim shkencëtarë, por krijojmë mjedis përritjen dhe edukimin e brezave, që fitojnë aftësi për të përbaluar çdo gjë që koha sjell nesër'.

8. Ju keni shumë impenjime, a ju del koha për të qenë e pranishme në të gjitha? Na thoni ndonjë sekret të menaxhimit të kohës.

Irena – Luftën me kohën nuk e fitoj gjithmonë. Shpesh e gjej veten në faj, që nuk mund t'i ndjek të gjitha ato që dëshiroj apo planifikoj. Natyrisht vendos prioritetet dhe në krye të tyre vendos mirëqenien e nxënësve. Ndoshta nuk mund të ndjek një aktivitet apo orë mësimi, por kohën për shqetësimet apo ankesa të nxënësve e gjej të parën. Edhe për dëshira që nuk presin ...

9. Për nxënësit Albanë, që po lexojnë këtë intervistë, a mund të zbulojmë ndonjë projekt, aktivitet a surprizë që ju me mësuesit keni rezervuar për këtë vit mësimor?

Irena – Për kënaqësinë tuaj do të zbuloj 2 ose më mirë, 3 aktivitete me interes. Këtë vit do të realizojmë një klip, që do të tregojë aktivitetet e shkollës sonë dhe që në sfond do ketë himnin e shkollës. Është një projekt 1 vjeçar dhe shumë i mirëpërgatitur.

Me qeverinë e nxënësve kemi diskutuar për shumë aktivitete, por më i madhi do të jetë "Albanët got talent". Edhe projekti i revistës me 3 numra në vit, nuk është projekt i lehtë.

Ju falenderojmë që pranuat t'ju intervistonim dhe për kohën që na kushtuat!

Irena – Ishte intervista me pyetjet më të bukura, që kam dhënë dhe më dha shumë kënaqësi. Faleminderit dhe suksese revistës "Albanët"!

KARTA E PERFORMANCES

ALBANËT RIPOZICIONOHEN NË VENDIN E “ARGJENDTË”

Përsëri Albanët renditen në vendin e dytë mes 33 shkollave 9-vjeçare jopublike të Tiranës. Sipas vlerësimit të MAS⁺ për vitin 2023, Albanët në kartën e performancës ripozicionohen në vendin e “argjendtë”.

Zyra Vendore e Arsimit në Tiranë ka publikuar renditjen, pasi ka analizuar një sërë treguesish, saktësisht pesëmbëdhjetë të tillë, që bazohen në rezultatet e arritura nga nxënësit, kualifikimin e mësuesve, programet mësimore, përqindja e mungesave në raport me pjesëmarrjen e nxënësve, nota mesatare e shkollës, përqindja e nxënësve kalues në provimet e lirimit, diferenca e notës mesatare me provimet kombëtare, sondazhi i prindërve, etj.

Karta e performancës së shkollës është një sistem i projektuar për të dhënë informacion të dobishëm dhe kompleks për arritjet e shkollës gjatë një viti mësimor.

Ajo garanton cilësinë e ofertës së shkollës përmes treguesve të standartizuar duke ju shërbyer prindërve, si edhe vetë institucionit e strukturave, të gjykojnë për arritjet, por edhe mbi nevojat për përmirësim.



ALBANËT
SHKOLLA 9-VJEÇARE



Një eksperiencë përgjegjësie e maturimi.

Të shprehësh mendimin dhe KY të të dëgjohet është një e drejtë që i takon të gjithëve, pra edhe fëmijëve. Jo me fjalë, as me objektiva në letër. Fëmijët mund ta mësojnë demokracinë vetëm duke e ushtruar realisht atë.

Ndaj në shkollën "Albanët" për vitin mësimor 2023-2024 është zhvilluar procesi i kandidimit dhe votimit për qeverinë e nxënësve, një detyrim ky ligjor për çdo institucion arsimor.

Çdo klasë ka treguar interes e përkushtim ap^{er}ut në këtë proces. Nxënësit kandidatë për senator e president të qeverisë kanë kërkuar votën e shokëve të klasës duke prezantuar platformat e tyre konkrete dhe të mirëdetajuara.

Pas zgjedhjeve nëpër klasa, senatorët votuan për presidentin e shkollës, që për këtë vit do të jetë nxënësja e klases së tetë Jerina Xhetani dhe si zv/president u zgjodh nxënësja e klasës së nëntë, Ambra Dizdari.

Ka qenë ky një proces, ku është parë qartë ndjenja e pjesëmarrjes, ku vetë nxënësit janë ndjerë iniciatorë dhe të përfshirë në zgjidhjen e problemeve si dhe përmirësimin e mjedisit shkollor, si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit.



Ja cilat ishin rezultatet e këtij procesi në shkollën "Albanët"

• Klasa 5 A

Senator: Aria Dizdari
Zv/senator: Egi Erzeni
Sekretar: Elma Bleta

• Klasa 5 B

Enes Hysenaj
Henki Duraj
Amelia Pina

• Klasa 6

Matias Peçi
Leart Imaj
Anja Likaj

• Klasa 7


Senator: Amelia Kolgjini
Zv/senator: Antigona Gora
Sekretar: Nensi Kota
Anëtar: Diora Kadëna
Dea Përpalaj

• Klasa 8

Kres Kashta
Jerina Xhetani
Lulzim Nushi

• Klasa 9

Marli Zhugli
Rea Zenelaj
Ambra Dizdari



TETORI I LIBRIT

Tetori solli shumë miq të fëmijëve, të ftuar të veçantë e njerëz të letërsisë, librit dhe arteve në shkollën Albanët. Figura ndryshe, shembuj frymëzimi, nga ata që për fat të keq i shohim pak në "tregun e influencuesve".

Kështu në këtë atmosferë fantastike në shkollën Albanët nxënësit më të apasionuar pas librave kanë biseduar, me një mike të albanëve. Quhet Suela Mino.

Është ajo punonjësja e bibliotekës që për herë të parë në Shqipëri bëri të funksionojë koncepti i bibliotekës lëvizëse, që për herë të parë "shkundi" prindërit për të dhënë hua librat e fëmijëve të tyre për të tjerë fëmijë në shkollat e fshatit dhe për ata në ngujim nga gjakmarrja, ajo që kërkoi libra dhe jo para nga bankat, bashkitë e bizneset, ajo që i bëri fëmijët të lexojnë më shumë.



Ndërsa klasat e pesta kishin ftuar autorin e rreth 50 titujve, Viktor Canosinaj, gjithashtu një mik i fëmijëve e po aq edhe nxënësve albanë.

Ishte një takimi ky, që ndoqi rrjedhën e fëmijëve, pasi moderatorë dhe intervistues ishin vetë ata. Nxënësit e pyetën për gjëra që as ndoshta as vetë shkrimtarit, mund të mos i kenë shkuar ndonjëherë në mendje.

Ata e pyetën se si quhet muza e tij, se a mund të jilihë liria me lel, për sfidat që kalon një shkrimtar dhe nëse me pavetëdije ndodh që autori të copëzojë veten tek personazhe e veta. E po ashtu një tjetër autore librash ka qenë e ftuar në shkollën Albanët gjatë muajit të letërsisë. Autorja e shumë librave për fëmijë, Lefteri Gjosha, ka biseduar me nxënësit e klasave dyta dhe të treta rreth magjisë së krijimit, mesazheve pozitive e të dobishme, që mund të marrim nga letërsia dhe faktit se sa e rëndësishme është të ushqejmë shpirtin me vlera të vërteta.



Janë në klasën e parë. Kanë filluar të miqësohen me librin dhe dita tës po lexojnë fiali e paragrafë.

Mësuesja në klasë ju esuar si "lind" një libër nga idetë dhe pena e autorëve dhe pastaj kanë vizituar një shtypshkronjë, ku libri shtypet, faqoset, pritet e lidhet për të marrë formën e tij e për të shkuar pas kësaj në duart e lexuesve. Nuk munguan as pyetjet, që morën përgjigje me dem strime e sqarime!

Faleminderit shtypshkronja Filara për mikpritjen dhe dhuratat me libra interesantë! Edhe klasat e dyta dhe t eta kanë q e miq në një tjetër shtypshkronjë, nga ato që janë gjithmonë miq të fëmijëve. Atje xënësit albanë "gostitën" të gjithë me libra fantastikë. Faleminderit shtypshkronja A&A!



Autorja e shumë librave për fëmijë, Lefteri Gjosha, ka biseduar me nxënësit e klasave të dyta dhe të tretra rreth magjisë së krijimit, mesazheve pozitive e të dobishme që mund të marrim nga letërsia, dhe faktit se sa e rëndësishme është të ushqejmë shpirtin me vlera të vërteta.



Ky që shihni në foto me mësuesen e tij është nxënësi i klasës së tretë në shkollën Albanët. Quhet Ernes Demolli dhe është kampion i leximit.

Mësuese Servete Cenalla prej tre vitesh organizon çdo muaj tetor një garë, tashmë traditë: "Lexuesi më i mirë i vitit" Për këtë vit mësimor (2023-2024) fituesi është Ernesti me 132 libra të lexuar gjatë tre viteve tek Albanët, për tu ndjekur nga nxënësja Kristel Ristani me 63 tituj librash, Ana Biba me 51, Emma Xhafa me 50 dhe Sofi Karalliu me 27 libra të lexuar.

Suksese të gjithë nxënësve e mësueses në këtë supernismë!

ALBANËT HI-TECH

Ne fëmijët dhe adoeshentët, jemi mësuar të dëgjojmë shpesh "refrenin" e prindërve tanë: "Mjaft me kompjuterin, celuarin, apo çdo lloj ekranë! Ata të dëmtojnë!"

Po është e vërtetë! Nëse i përdorim pa masë e për qëllime të padobishme, ata të dëmtojnë.

Por e ardhmja është vërtet e orientuar nga teknologjia dhe fëmijët, janë e ardhmja. Në shkollën Albanët ka mjaft nxënës, që jo vetëm e "konsumojnë", por edhe "krijojnë" produkt teknologjik. Po ju njohim me disa prej nxënësve tanë "Hi Tech"!



Kjo vajza simpatike quhet Dian Çauşolli dhe është nxënëse e klasës së pestë në shkollën Albanët.

Prej 4 muajsh ajo ka hapur kanalin e saj në You Tube bashkë me Solarën, motrën 4 vjeçë.

Best Sisters World ka publikuar rreth 1.1 K shorts-a (video) dhe ka deri tani gati 39 K subscribers.

Dian thotë se frymëzohet nga YouTuber-i më i njojur në botë për momentin, Jimmy Donaldson (MrBeast), 25 vjeçari, që ka thyer të gjitha rekordet e këtij aplikacioni.

Por De thotë gjithashtu se model dhe shembull kryesor për të është dhe mbetet familja. Mami i saj, gazetare në profesion, ka gjithashtu një kanal të vetin në tube, motra e dytë ka një tjeter kanal të sajin, por gjithsesi De thotë, se ajo ka më shumë ndjekës se motra e madhe dhe për pak po i afrohet në rekorde edhe mamit.

Sigurisht që De ka patur dhe ka një strategji të qartë për tregun ndërkombëtar, pa e kufizuar me elementin e gjuhës, komunikimin e saj on-line me ndjekësit.





Ky është Ivi Kraja, nxënës alban në klasën e gjashtë. Është gjimnast dhe kitarist, por për dy orë në ditë ai përpinqet “të mos e prishë kompjuterin” (kështu i thonë prindërit). Në fakt ai nuk prish, por ndërton! Është një game creator. Veç lojave ai ndërton interior design, planimetri ndërtuesash, lexon për arkitekturën dhe ndihmon shuuumë babin me ide profesionale, sidomos kur shkojnë bashkë në një kantier ndërtimi. Krijimi i lojave në kompjuter, Ivi thotë se e ndihmon “të mos përhumbë” dhe i jep dëshirë për të vazhduar më tej rrugën e “ndërtuesit” të ëndërrave 🤗



Rejan Miloti është në klasën e nëntë. Biseda me të është e “mençur”. Rejan mendon se njerëzimi ka nevojë për njerëz ambiciozë, por ambicjet duhet tëjenë pozitive, si p.sh: të jesh njeri e shok i mirë, pastaj edhe nxënës i mirë, po munde. Ai është një programues. Thotë se ishte babai, ai që e futi në “grackën” e programimit duke i treguar video, por gjithsesi Rejan mendon se “do bëhej pjesë e këtij pasioni, pasi është një nga profesionet më të paguara në treg dhe sepse gjithçka tashmë, do priret drejt teknologjisë”. Ai zhvillon e dizajnon faqe web-i, sisteme e aplikacione, editon foto dhe video në paketa e programe profesionale si Adobe, Capcut, After Effect etj.

Rejan mendon se ligji shqiptar “ka mbetur mbrapa” duke e ndaluar punësimin nën 18 vjeç, sepse ai thotë se mund të punojë online, por nënvizon se “ligji për pajisjen me patentë, duhet të mbetet siç është, pasi është më i mirë ai në Amerikë”.

Suksese në makro-analizat e tua Rejan!

Reportazh

Ishim tē gjithë shënd e verë. Edhe pse mesi i vjeshtës së dytë, ishte një ditë e ngrohtë. Me një grup tē madh rreth 150 nxënës dhe “një autokolonë” me mjete transporti ndaluam tek Ferma Albanët. Në hyrje sipër kokave tona qëndronte një hark me degë shegësh e kokrra tē pjekura, çuditërisht shuumë tē mëdha.



Natyra na ftonte ta shijonim, ta njnnim, ta donim. Në fermë na priste një organizim sipas klasave. Një klasë e parë vrapi tē ushqente lepujt dhe kafshët e minikopshtit zoologjik, klasa e dyta po mblidhje gjethet e rëna tē vjeshtës, sepse mësuesja e artit na ftoi tē bënim punimet tona mbi tavolina apo në



Më të rriturit po vilnin nga pemët ullinjtë e pjekur e shegët plot lëng. Pastaj pamë bimët në parcela e nëpër sera, ju shërbyem bashkë me punonjëset e fermës dhe natyrisht me mësuesen, pastaj ilustruam atë që kishim mësuar gjatë javës në orën e Diturisë së Natyrës. Pamë rrënjet e lëmëve, kërcellin, gjethet dhe frutat në bollëk e harmoni, siç vetëm natyra di t'i rendisë gjërat.



Në fund rraahën e kishte pjesa ë e bukur. Argëtimi në këndin e lojrave dhe shijimi i frutave të fermës. Ku tjetër veç Fermës Albanët, fëmijët do të mësonin e përfitonin kaq shumë, thjesht duke u kënaqur?!
Eshtë e vëtmja ekonomi agro-blegtorale në Tiranë me fokus edukimin, ku fëmijët mund të argëtohen e të edukohen me përgjegjësinë e kujdesit për natyrën.



Ferma Albanët gjendet vetëm 15 minuta larg nga qendra e Tiranës, në Gropaj, Prush, ndaj të gjithë fëmijët dhe familjet nuk duhet ta humbin këtë kënd kënaqësie e paqeje pranë natyrës.

MANDALA

Mësuese Ina ka menduar, që për nxënësit e Albanëve, të mos ofrojë vetëm leksione dhe kurse arti, por edhe terapi arti. Si?! E po le të themi duke i çuar një grup nxënësish në orient, në Indinë e largët. Ejj! Prindër! Relax! Ishte metafarë!

Përgjigjja është nëpërmjet qetësisë, që të jepin pjesëzat e vogla e të përsëritura ritmikisht të figurave mandala. Një itenerar gjeometrik drejtësisë dhe fokusit për të ndihmuar nxënësit tanë për tu shtendosur dhe qetësuar, pasi si gjithë bashkëmoshatarët e tyre duhet të qëndrojnë në shkollë me orë të zgjatura edhe pas mësimit.

Si fillim, botimi i parë i këtij lloji, i kushtohet grupit të studimit për klasat e 1^a, për të vijuar mandej si projekt edhe me botime pasuese për nxënës të grupmoshave të tjera.

Ky është një botim i mirënjohur nga mësuesja e artit në shkollën Albanët, Ina Kadëna, që vjen për fëmijët, jo vetëm si një mënyrë tipike dhe argëtuëse për ngjyrosje, por më tepër se kaq është një sërë perceptimesh dbe ndjesish ngjyrore, të cilat nxisin prodhimin e seratoninës, hormonit të lumturisë dhe miqënieve.

Kjo terapi është përshtatur dhe konceptuar në formën e një libri për nxënësit e klasës së parë. Në mënyrë që imazhet të jenë të qarta dhe sa më të kuptueshme për ta duke zgjedhur elementë me silueta shumë të njohura, forma të dashura dhe figura kafshësh, sendesh apo objektesh, të cilat lidhen me përditshmërinë duke ndjekur po ashtu edhe ritmin e stirrave apo festave.

